



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

11/2829/2019

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONET NË BUJQËSI

Njoftohen të gjithë fermerët-et të cilët janë të interesuar të aplikojnë për subvencionim nga komuna e Hanit të Elezit, gjegjësisht nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2019.

Subvencionimi bëhet në këto sektore:

- Mbjellje të grurit me sipërfaqe **nën 2ha**, në vlerë prej **130 €/ha**.
- Subvencionim për fermerët që kanë të mbjellur kultura në serra mbi 4 ari nga 30€ për ari.
- Subvencionim për fermerët që kanë pula vojse të fituara donacion prej LAB-it nga viti 2017 që kanë afatin për ndërrimin e pulave të vjetëra në ato të reja, në shumë prej 300 € për fermer.
- Kultivimin e mjedrës mbi 10 ari nga 5.00€ për ari.
- Kultivimin e dredhës (Luleshtrydhe) mbi 10 ari nga 5.00€ për ari.

Dokumentacionet e nevojshme për aplikim:

- Letërnjoftimi i, e aplikuesit/aplikueses - kopje ose Pasaporta -kopje
- Konfirmimi i Xhirollogarisë Bankare
- Vërtetimi i tatimit në pronë mbi obligimet e kryera.
- Dëshmia kadastrale e sipërfaqes së mbjellur me grurë, mjedra, dredhëz (luleshtrydhe) dhe serra.
- Kontrata kopje me LAB-in për pulat vojse.

Kriteret për subvencionim :

- Duhet të jetë banor-e/i, e Hanit të Elezit.
- Sipërfaqja e tokës duhet të jetë në territorin e komunës Hani i Elezit.
- Parcelat e mbjellura duhet të jenë minimum 0.10 ha për grurë, mjedër dhe luleshtrydhe.
- Dëshmia që kanë ndërruar numërin e pulave vojse të vjetëra në të reja.
- Fermerët që kanë aplikuar për subvencionim në MBPZHR për mbjellje të grurit nuk kanë drejtë të aplikojnë edhe për subvencionim nga komuna.

*Afati për aplikim është nga 01.04.2019 deri me 15.04.2019 ora 16:00
Aplikacionet dorëzohen në qendrën për shërbim të qytetarëve.*

Data: 01.04.2019

Me respekt,



Drejtori i DBPZHR-së
ZAIM BELA